



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 07

Prishtinë, më 01 mars 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Adem Salihaj, Armend Zemaj, Mufera Şinik dhe Kolë Berisha.

**Munguan:** Vladimir Todorović dhe Selvije Halimi.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Albulena Ademi - NDI, Dafina Bardhyli – NDI, Lumnije Murati ZPRK, dhe Lejla Selimi – OSBE, Rrezarta Ahmeti - KDI, Dresha Gaxherri BOOM TV, Sylë Ahmeti – Kosova Sot.

**Nga staffi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22 shkurtit 2010,
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit për Gazetën Zyrtare,
4. Të ndryshme.

*Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22 shkurtit 2010**

**Kryetari** - Konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22 shkurt 2010 me vërejtjet e Armend Zemajt dhe të Adem Hajdarajt.

**Armend Zemaj** – Vuri në pah se ku thuhet “*që zhvillohet në Kosovë*” duhet të jetë “*që janë në Kosovë*”.

**Adem Hajdaraj** - Tha se nuk kishte thënë “*nuk është gjuhë standarde*”, por “*nuk e di a është gjuhë Standarde?*”

## **3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit për Gazetën Zyrtare**

**Kryetari** – I paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet e Komisionit, propozimet e komunitetit turk dhe propozimet e deputetit Riza Smaka. Për Komisionin diskutabile ishte neni 5, parag. 1 dhe 2. Këto dilema u hoqën pas konsultimeve me sponsorizuesin e Ligjit, si dhe me përfaqësuesit e tjerë, sepse gjuha ishte e pastandardizuar dhe nuk i plotësonte kushtet për publikim. Në vazhdim tha se amendamenti i Komisionit kërkon që neni 5, paragrafi 1, të riformulohet “*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në gjuhën shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe angleze*”. Ndërsa kur u fol për nenin 5, paragrafi 2, e përkrahu amendamentin e grupit të deputetëve të komunitetit turk.

**Ibrahim Makolli** - U pajtua me parafolësin dhe ceku se pasi e bëmë amendamentin që Gazeta Zyrtare të publikohet në gjuhët: shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe angleze, doli se nuk ka nevojë të ekzistojë paragrafi 2 i këtij neni.

*Komisioni e përkrahu amendamentin e deputetëve të komuniteti turk që neni 5, paragrafi 2 të hiqet.*

***Kryetari** konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime e nxori këtë*

### **PËRFUNDIM**

*Miratohen amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe procedohen për shqyrtim të mëtejme.*

#### **Amendamenti I**

Neni 5

5.1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në këto gjuhë: shqip, serbisht, turqisht, boshnjakisht dhe anglisht.

Neni 5, paragrafi 2 hiqet.

#### **Amendamenti II**

Neni 7

7.9 Në rreshtin e parë fjala “**që**” hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “**i cili**”.

### **Amendamenti III**

Neni 10

Neni 10, paragrafi 1.4 hiqet.

### **Amendamenti IV**

Neni 12

12.1 Në rreshtin e dytë dhe në të tretin kudo që haset fjala “**dhe**”, hiqet.

### **Amendamenti V**

Neni 15

15.2 Në rreshtin e katërt fjala “**nxjerrur**“ hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “**nxjerrë**“.

### **Amendamenti VI**

Neni 16

16.1 hiqet.

*Komisioni nuk i përkrahu amendamentet e propozuara nga deputeti Riza Smaka, që paraqiten në vijim:*

### **Amendamenti I**

Në nenin 4 të LGZ-së

“Botimi i Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare) bëhet në formë të shtypur dhe në formë elektronike”.

### **Amendamenti II**

Në nenin 4, paragrafët 1 dhe 2 të LGZ-së

Me propozimin të bashkohet në një paragraf dhe të formulohet, si vijon:

“2.2. Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të shpallura nga Presidenti i Republikës së Kosovës”.

### **Amendamenti III**

Në nenin 5 të LGZ-së

“Aktet ligjore publikohen në Gazetën Zyrtare në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, si dhe në ato boshnjake, turke dhe angleze”

### **Amendamenti IV**

Neni 15 paragrafi 2 i LGZ-së

“Ankesat në paragrafin 1 të këtij neni, Zyra e Gazetës Zyrtare i shqyrton dhe vendos në përputhje me Ligjin”.

#### 4. Të ndryshme.

##### a. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Avokatin e Popullit

**Kryetari** - Njoftoi se Komisioni e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për Avokatin e Popullit, por ka kërkuar edhe nga Kryetari i Kuvendit që t'i dërgohet Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Në vazhdim tha se si Komision kemi një numër të madh të ligjeve dhe jemi shumë të ngarkuar. Nuk do ta kundërshtojmë të mos e marrim këtë projektligj, të cilin brenda mundësive do t'ia dërgojmë Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi është i ngarkuar edhe me agjendën legjislative, edhe me planin e punës së Kuvendit. Mirëpo nëse ky është vullneti i Komisionit ne do ta shqyrtojmë.

**Ibrahim Makolli** - Tha se Komisioni për zgjedhjen e Avokatit të Popullit përbëhej nga anëtarë të të dy komisioneve. Ishte i mendimit se do të duhej të bisedohej me kryetarin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut që të krijohet një nënkomision i veçantë, me anëtarët e të dy komisioneve; të punohet dhe të mbahet një takim i përbashkët, në të cilin do të shqyrtohen amendamentet e këtij nënkomisioni.

**Adem Salihaj** – E dimë se jemi Komisioni më i ngarkuar. Ceku se Projektligji duhet të kalojë te njëri komision dhe të mos krijohet një komision i përzier nga të dy komisionet. E përkrahu mendimin që ky projektligj t'i kalojë Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Nuk ishte kundër që të mbetet edhe në Komisionin për Legjislacion, mirëpo kërkoi të përcaktohet cili komision duhet ta shqyrtojë.

**Armend Zemaj** - Tha se bashkëpunimi me komisionet e tjera nuk na bën dëm, mirëpo meqë Avokati i Popullit është kategori kushtetuese i një rëndësie të veçantë, konsideroi se si komision i ligjeve, duhet të merret Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

**Ibrahim Makolli** - Theksoi se Projektligji për Avokatin e Popullit i përket Komisionit për të Drejtat e Njeriut, sepse Avokati i Popullit korrespondon drejtpërdrejt me të, pavarësisht se këtë ligj e ka draftuar Ministria e Drejtësisë. Unë propozova të krijohet një nënkomision i përbashkët. Projektligji me strategjinë legjislative është në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, sepse në të kaluarën nuk ka pasur Komision për të Drejtat e Njeriut, përndryshe Komisioni për të Drejtat e Njeriut do të duhej të merrej me të.

**Adem Salihaj** - Ishte i mendimit se Projektligji duhet të kalojë te Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, sepse konsideron se për ta shqyrtuar është më përgjegjës.

**Bajram Kosumi** - U pajtua me parafolësit se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi do të duhej ta shqyrtonte këtë projektligj për shumë arsye, sepse është një pikë shumë e ndjeshme. Edhe propozuesi i ka pasur parasysh disa faktorë pse duhet t'i dërgohet Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Konsideron se ky komision duhet ta shqyrtojë këtë projektligj.

**Kryetari** - Tha se si Komision e përkrahim në parim Projektligjin, por t'i shohim rekomandimet e Kuvendit a e mundësojnë kalimin tij në Komisionin për të Drejtat e Njeriut.

*Kundër propozimit që Projektligji të shqyrtohet në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi ishin: Ibrahim Makolli, Adem Hajdaraj dhe Kolë Berisha.*

#### **b. Njoftim lidhur me mbikëqyrjen e Ligjit për faljen**

**Kryetari** – Vuri në pah se Komisioni e ka marrë për detyrë mbikëqyrjen e Ligjit për faljen. Propozoi që Ibrahim Makolli, Armend Zemaj dhe Ramadan Gashi të jenë nëngrupi, i cili do të hartojë planin e veprimit për mbikëqyrjen e Ligjit për faljen, në bashkëpunim me organizatat e tjera që e mbështesin Komisionin.

**Ibrahim Makolli** - Theksoi se është i interesuar t'i shikojmë formën, mënyrën dhe kriteret e faljes së fundit nga Presidenti dhe të kontaktojmë me Zyrën e Presidentit që të na ofrojë dokumentacion të nevojshëm.

#### **c. Njoftim për mbajtjen e dëgjimit publik**

**Kryetari** - Njoftoi se Komisioni më 09. 03. 2010, në orën 11:00, do të mbajë dëgjim publik për shqyrtimin e Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

**Përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Bahri Hyseni**